



Pranimat / Dorezuar Primesha / Pradato Received / Delivery	01.12.2022	2 vit god year	
Organ / Njësia Organ / Jedinstva Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKMSTOK	7580/2022		115



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.960/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani anëtarë, si dhe Sabile Avdyli-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.960/2022 të datës 31.10.2022 të parashtruar nga ankuesi [redacted] me adresë banimi [redacted] kundër njoftimit të datës 16.09.2022 të Njësisë te Burimeve Njerëzore Komuna e Prishtinës, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 01.12.2022, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pa bazuar Ankesa me numër A.nr.960/2022 e datës 31.10.2022 e parashtruar nga ankuesi [redacted]

II. Mbeten në fuqi Vendimet e datës 30.09.2022 i Komisionit Vlerësues të Komunës së Prishtinës për refuzimin e ankesave të ankuesit për pozitat: "Zyrtar i Lartë për Kadastër dhe Gjeodezi" dhe "Zyrtar për Kadastër".

Arsyetim

Ankuesi [redacted] ka aplikuar në konkursin e shpallur për lëvizje brenda kategorisë për pozitën e punës "Zyrtar i Lartë për Kadastër dhe Gjeodezi" me numër reference RN00009290 dhe në pozitën "Zyrtar për Kadastër" me numër reference RN00009292 të dy këto pozita të shpallura me datën 14.07.2022-21.07.2022 sipas njoftimit të datës 29.06.2022.

Sektori i Burimeve Njerëzore ne kuadër te Komunës se Prishtinës me datë 16.09.2022 ka nxjerr Njoftim për anulim të konkursit të datës 27.07.2022 për pozitën "Zyrtar për Kadastër" me numër reference RN00009292 te datës 29.06.2022 për lëvizje brenda kategorisë, me arsyetimin se asnjë nga kandidatet nuk ka arritur pikët e mjaftueshme për përzgjedhje. Po ashtu Sektori i Burimeve Njerëzore ne kuadër te Komunës se Prishtinës me datë 16.09.2022 ka nxjerr njoftim për anulim të konkursit të datës 27.07.2022 për pozitën "Zyrtar i Lartë për Kadastër dhe Gjeodezi" me numër reference RN00009290 te datës 29.06.2022 për lëvizje brenda kategorisë, me arsyetimin se asnjë nga kandidatet nuk ka arritur pikët e mjaftueshme për përzgjedhje.

Kundër Njoftimit për anulim të konkursit , ankuesi me datë 21.09.2022 ka parashtruar ankesë te Komisioni Përzgjedhës në Komunën e Prishtinës me pretendimin ankimor se vlerësimi nuk ka qenë i drejtë. Njësia e Burimeve Njerëzore me datën 30.09.2022 nxjerrë dy vendime me të cilat refuzon ankesën e ankuesit për pozitën: Zyrtar i lartë për kadastër dhe gjeodezi dhe Zyrtar për kadastër.

I pakënaqur me vendimet e datës 30.09.2022 të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Prishtinës, ankuesi me datën 31.10.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 6571/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, më datë 01.11.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Prishtinës, ndërsa kjo e fundit me datë 16.11.2022 ka përcjell përgjigjen në ankesë me numër protokollit 7169/2022 së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave me rastin e vendimmarrjes, ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 6571/2022 të datës 31.10.2022 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Akt emërimi i datës 20.05.2019 me nr.103/02-8546/10; ID kartela e ankuesit I.K; Kopja e letërnjoftimit; Njoftimi i datës 17.10.2022 përmes e-mailit nga SIMBNJ; Vendimi i datës 30.09.2022 i Komisionit Vlerësues; Rezultatet e vlerësimit te datës 16.09.2022; Të dhënat e shpalljes te datës 29.06.2022; Ankesë e datës 21.09.2022; Njoftim i datës 16.09.2022 i Menagjerit të Burimeve Njerëzore; Njoftimi i datës 27.07.2022 me email nga SIMBNJ; Njoftimi i datës 19.08.2022 me email nga Komuna e Prishtinës; Vendim i datës 09.08.2022 nga Komuna e Prishtinës; Vendim i datës 27.07.2022 nga Komuna e Prishtinës; Konkursi i datës 29.06.2022 për pozitën "Zyrtar i Lartë për Kadastër dhe Gjeodezi" me numër RN00009290; Konkursi i datës 29.06.2022 për pozitën "Zyrtar për Kadastër" me numër RN00009292; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 01.11.2022; Përgjigjen në ankesë nga Komuna e Prishtinës me numër protokollit 7169/2022 së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës; Renditja përfundimtare e kandidatëve nga SIMBNJ e datës 16.09.2022; Pasqyra e llogarisë në Trustë i datës 11.12.2020; Çertifikatë e datës 09.02.2022 e lëshuar nga Gjykata Themelore në Ferizaj; Certificate e datës 04.04.2019; Certificate e datës 17.05.2019; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë e datës 14.01.2020; Pasqyra e llogarisë në Trustë prej datës 29.12.2010-14.07.2022; Diplomë e datës 08.02.2010 me nr.792 e lëshuar nga Fakulteti Juridik në Universitetin e Prishtinës; kopje nga Noteri nr.LRP.3532/2021; Diplomë e masterit e datës 18.06.2015 me nr.889 e lëshuar nga Fakulteti Juridik në Universitetin "Hasan Prishtina" nga Noteri LRP.3531/2021 ; Vërtetim punësimi nga Zyra Noteriale ne Kaçanik e datës 06.04.2022; Vërtetim punësimi nga

kompania Dauti-Komerc ne Ferizaj e datës 15.05.2019 dhe Aplikacioni me numër RN00009292 i datës 20.07.2022 dhe Vendimi i datës 12.07.2022 me nr.14-020/01-1515/2022 për formimin e Komisionit Përzgjedhës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit dhe analizimit të provave të lëndës, konstatoi se ankesa e ankuesit është e pabazuar, **SEPSE:**

Nga administrimi i shkresave të lëndës është konstatuar së më datë 29.06.2022 në Sistemin Informativ për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore (SIMBNJ) është shpallur njoftimi lidhur me hapjen e konkursit për *lëvizje brenda kategorisë* për pozitën e punës "Zyrtar i Lartë për kadastër dhe Gjeodezi" me numër reference RN00009290 dhe "Zyrtar për Kadastër" në Komunën e Prishtinës, Konkursi në fjalë ka qenë i hapur nga data 14.07.2022 deri me datë 21.07.2022, dhe si kritere të përgjithshme formale për pozitën "Zyrtar i Lartë për Kadastër dhe Gjeodezi" kanë qenë të përcaktuara:

Arsimimi i kërkuar: Diploma e studimeve universitare me të paktën 240 kredi/ECTS në Fakultetin Juridik, Gjeodezi dhe fusha e Diplomës Master të jetë e njëjtë apo vazhdim i , Financa dhe Kontabilitet me të paktën 240 kredi/ECTS apo ekuivalente me to. Diplomën Master të jetë e njëjte apo vazhdim i diplomës Bachelor;

Përvoja e punës: së paku dy (2) vite përvojë pune profesionale në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës se lire të punës.

Ndërsa si kritere të përgjithshme formale për pozitën "Zyrtar për Kadaster" kanë qenë të përcaktuara:

Arsimimi i kërkuar: Diploma e studimeve universitare me të paktën 180 kredi/ECTS apo ekuivalente me to, Fakultetin Juridik

Përvoja e punës: së paku dy (2) vite përvojë pune profesionale në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës se lire të punës.

Sipas shkresave të lëndës rezultoi se ankuesi me datë 20.07.2022 ka aplikuar në konkursin e shpallur për lëvizje brenda kategorisë për pozitën e punës "Zyrtar i Lartë për Kadastër dhe Gjeodezi" dhe pozitën "Zyrtar për Gjeodezi" me numër reference RN00009292 në Komunën e Prishtinës, i cili pas intervistës në këtë pozitë "Zyrtar i Lartë për Kadastër dhe Gjeodezi" ka marrë 34.8 pikë. I njëjti po me të njëjtën datë ka aplikuar edhe për pozitën Zyrtar për Kadastër dhe i cili në intervistën me gojë ka marrë 34.2 pikë.

Pas procedurës së intervistimit e cila është mbajtur me datën 23.08.2022 për të dy pozitat e ku kandidat i vetëm i cili i ka plotësuar kriteret e konkursit ka qenë ankuesi mirëpo në asnjërën pozitë nuk ka arrit pikët e mjaftueshme për përzgjedhje, Njësia e Burimeve Njerëzore me datën 16.09.2022 nxjerr njoftimin për anulimin e konkursit për pozitën "Zyrtar i Lartë për Kadastër dhe Gjeodezi" dhe "Zyrtar për Kadastër" pasi në asnjërën pozitë nuk ka kandidatë që kanë arritur pikët e mjaftueshme për përzgjedhje.

Kundër njoftimit të datës 16.09.2022 ankuesi me datën 21.09.2022 ka parashtruar ankesë për Komisionin përzgjedhës të Komunës së Prishtinës i cili pretendon që të bëhet anulimi i njoftimit të datës 16.09.2022 dhe të përzgjidhem për njërin pozitë ose të përsëritet intervistimi me gojë për

dy pozitat veç e veç ashtu siç parashihet në Rregulloren (QRK) NR.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Kosovës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave lidhur me pretendimet ankimore të ankuesit ka shqyrtuar shkresat e lëndës një nga një dhe gjitha se bashku dhe rrjedhimisht ka konstatuar se ankuesi ka përfunduar studimet themelore me datë 08.02.2010 dhe ka marrë titullin Bachelor i Drejtësisë me gjithsej 180 kredi/ECTS, Diplomën Master të datës 13.06.2015 të lëshuar nga Fakulteti Juridik në Universitetin "Hasan Prishtina" Në Prishtinë; Vërtetimin e datës 06.04.2022 të lëshuar nga zyra e noterit i cili ka punuar prej datës 01.01.,2015-30.09.2017; vërtetim i datës 15.05.2019 me të cilin vërtetohet se ankuesi ka punuar në Kompaninë Dauti-Komerc prej datës 01.10.2017 deri më datën 15.05.2019 dhe prej datës 20.05.2019 në Komunën e Kaçanikut sipas Akt emërimit të datës 20.05.2019 Zyrtar për regjistrimin e pronave të paluajtshme.

Andaj, bazuar si me sipër Kolegji vlerëson se ankuesi me rastin e aplikimit për pozitën përkatëse të punës, ku afati i aplikimit ishte nga data 14.07.2022 deri më datën 21.07.2022 i ka plotësuar kriteret e konkursit por nuk ka marrë pikët e mjaftueshme për përzgjedhje në asnjërën nga pozitat e shpallura në konkursin e datës 14.07.2022, kështu që organi i punësimit Komuna e Prishtinës me rastin e anulimit të konkursit të shpallur për lëvizje brenda kategorisë për pozitën e punës "Zyrtar i Lartë për Kadastër dhe Gjeodezi" me numër reference RN00009290 dhe në pozitën "Zyrtar për Kadastër" me numër reference RN00009292 sipas njoftimit të datës 16.09.2022 ka vepruar konform dispozitave të nenit 49 paragrafi 3 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës ku përcaktohet se "3.Nëse asnjë nga kandidatët nuk është vlerësuar me gjashtëdhjetë 60 e më shumë pikë, procedura e lëvizjes brenda kategorisë përfundon pa kandidat fitues". Në këtë kuptim Kolegji konstaton se pretendimet ankimore të ankuesit janë të paqëndrueshme dhe rrjedhimisht vlerëson se Njësia për Burime Njerëzore, me rastin e nxjerrjes së njoftimit të datës 16.09.2022 për anulimin e konkursit të shpallur për lëvizje brenda kategorisë për pozitën e punës "Zyrtar i Lartë për Kadastër dhe Gjeodezi" me numër reference RN00009290 dhe për pozitën "Zyrtar për Kadastër" me numër reference RN00009292 ka vërtetuar drejte dhe në mënyrë të plote gjendjen faktike dhe rrjedhimisht drejte ka zbatuar ligjin material, duke vepruar kështu në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-144 për Zyrtaret Publikë, dhe Rregullores Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Kështu që pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.



KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.960/2022, datë 01/12/2022

Sabile Avdyli

Sabile Avdyli

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dërgohet;

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Prishtinës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Prishtinës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.